

VENDIM
Nr. 311, datë 15.5.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), OPERATORIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE SHA) (AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT) DHE KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
PROGRAMIN E INVESTIMIT NË SHPËRNDARJEN E ENERGJISË I, MASAT
SHOQËRUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) (Agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për financimin e programit të investimit në shpërndarjen e energjisë I, masat shoqëruese, me një grant në shumën 2 000 000 (dy milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE FINANCIMI

E DATËS 5.3.2019 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË (“MARRËSI”) DHE OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHA (OSHEE) (“AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT”) PËR
SHUMËN 2,000,000.00 EURO

- Programi I i Investimeve mbi Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I: masat shoqëruese
BMZ-nr. 2015 70 365

KfW-ja dhe Marrësi synojnë të lidhin disa marrëveshje për projektin “Programin i investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I (“Programi”)”. Për masat shoqëruese të masave të investimit të marrëveshjes së huas të lidhur ndërmjet KfW-së dhe Marrësit për qëllime të Programit në vlerë prej 30,000,000 euro (“Marrëveshja e Huas”), Qeveria Gjermane ka siguruar fonde shtesë.

Në bazë të marrëveshjes nënshkruar në datën 14.12.2018 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (“Marrëveshja Qeveritare”), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-së lidhin Marrëveshjen e Financimit në vijim (“Marrëveshja”):

1. Shuma dhe Qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja do t’i japë Marrësit një kontribut financiar që nuk tejkalon shumën 2,000,000.00 EURO (“Kontributi financiar”).

Ky Kontribut Financiar nuk do të shlyhet, nëse nuk përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi do të kanalizojë Kontributin Financiar në mënyrë të plotë tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do

të përdorë Kontributin Financiar për financimin e shërbimeve të konsulencës në lidhje me asistencën teknike në përgatitjen, zbatimin dhe funksionimin e sapo instaluar të qendrës kombëtare të shpërndarjes (“NDC”). Kjo do të përfshijë, ndër të tjera, ndihmën me studimet përgatitore si studimet e fizibilitetit, llogaritjet e rrjedhjes së ngarkesës dhe analizën e rrjetit, si dhe mbështetjen për zbatimin e NDC-së dhe masat e trajnimit për personelin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit për të ndërtuar njohuri teknike në kuadër të organizimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit për funksionimin e përditshëm të NDC-së dhe komponentëve të tij të integruar të TI-së (“Shërbimet e Ekspertëve”) dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimit valutor. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet dhe fushëveprimin e Shërbimeve të Ekspertëve që do të financohen nga Kontributi Financiar me një Marrëveshje të Veçantë (“Marrëveshja e Veçantë”), e cila do të bashkë nënshkruhet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë në detaje kontributet homologe që do të zbatohen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të bashkë nënshkruhet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të japë kontributet e saj homologe plotësisht dhe në kohën e duhur. Agjencia e Zbatimit të Projektit do t’i paraqesë KfW-së, sipas kërkesës, dëshmi që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Tatimet dhe taksat e tjera publike që do të mbulohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe detyrimet e importit, nuk do të financohen nga Kontributi Financiar.

2. Kanalizimi i Kontributit Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi do të kanalizojë Kontributin Financiar të Agjencisë së Zbatimit të Projektit si një grant të pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje financiare të veçantë.

2.2 Para disbursimit të parë nga Kontributi Financiar, Marrësi do t’i japë KfW-së përkthimin në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Kontributit Financiar nuk do të përbëjë asnjë përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së, për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja do të disbursojë Kontributin Financiar në përputhje me ecurinë e Shërbimeve të Ekspertëve dhe sipas kërkesës së Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Nga Marrëveshja e Veçantë, Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara përdoren për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë pagesën pas datës 30 qershor 2024.

4. Pëzullimi i Disbursimit dhe Shlyerjes

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet vetëm nëse:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesa, kur është e nevojshme,

b) janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të veçanta që lidhen me këtë Marrëveshje,

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se Kontributi Financiar është përdorur për qëllimin e caktuar,

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje, shkel ligjin në fuqi, ose

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

4.2 Nëse ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 4.1 b), c) ose d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila megjithatë duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja,

a) në rastet e përcaktuara në nenin 4.1 b), mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 4.1 d) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave të tilla, pagesa e të cilave ndaj Marrësit ose largimi nga Marrësi përbën një shkelje të ligjit në fuqi;

c) në rastet e përcaktuara në nenin 4.1 c), mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumave të tilla, pasi Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se është përdorur për qëllimin e përcaktuar.

5. Shpenzimet dhe Pagesat Publike

Marrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha shpenzimet e transferimit dhe të konvertimit që rrjedhin në lidhje me disbursimin e Kontributit Financiar.

6. Deklaratat Kontraktuale dhe Kompetencat e Përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj në KfW dhe të autorizuar me modelet e nënshkrimeve të vërtetuara nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Marrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Agjencisë për Zbatimin e Projektit dhe personat e caktuar nga ai ose ajo në KfW dhe të autorizuar me modelet e nënshkrimeve të vërtetuara nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të skadojnë deri në momentin e pranimit të tyre nga përfaqësuesi i autorizuar i KfW-së.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dorëzuar nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të cilat ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe nuk do të kërkojnë miratime të tjera apo të mëtejshme qeveritare. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të cilat ndikojnë vetëm në marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe Marrësit nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Çdo njoftim ose deklaratë do merret sapo të ketë mbërritur në adresën vijuese të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Faks: +49 69 74312944

Për Marrësin:

Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Blvd. "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks: +35542228494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

Blvd. "Gjergj Fishta", nr. 88, H. 1

Njësia Administrative nr. 7

1023

Tiranë, Shqipëri

7. Shërbimet e ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit do të:

a) përgatisë dhe kryejë Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në

përputhje me konceptimin e rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve dhe për këtë do të përfitojë nga shërbimet e inxhinierëve të pavarur dhe të kualifikuar konsulentë;

b) japë kontratat për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Kontributi Financiar sipas ofertave paraprake ndërkombëtare konkurruese;

c) mbajë ose marrë masa që të mbahen regjistrime në mënyrë të qartë që specifikojnë të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe identifikimin e qartë të shërbimeve të financuara nga Kontributi Financiar;

d) mundësojë përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat në fjalë, si dhe të gjitha dokumentet e tjera përkatëse për ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet e tilla mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe për përparimin e tyre të mëtejshëm, siç mund të kërkojë KfW-ja.

7.2 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, do të:

a) sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe, sipas kërkesës, t'i japin KfW-së dëshmi që vërtetojnë se shpenzimet e paguara nga ky Kontribut Financiar nuk mbulohen;

b) njoftojnë vetë KfW-në menjëherë për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet përkatëse për nenet 7.1 dhe 7.2 nga Marrëveshja e Veçantë, e cila do të bashkë nënshkruhet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.4 Marrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, t'i japë Agjencinë e Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

8. Publikimi dhe Transferimi i Informacionit të lidhur me Shërbimet e Ekspertëve

8.1 Për të qenë në pajtim me parimet e transparencës të pranuar ndërkombëtarisht dhe efikasitetit më të lartë në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacione të përzgjedhura (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohen gjatë negociatave, para negociatave, ndërsa Marrëveshja është duke u zbatuar dhe në fazën pas-kontraktuese (në vijim e referuar si “Periudha Gjithëpërfshirëse”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e saj të biznesit “KfW Development Bank” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose palët e treta në pajtim me nenin 8.3 më poshtë) në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohen, nuk përfshijnë ndonjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar financiar ose biznesi të lidhur me palët e përfshira në Projekt ose financimin e saj, të tilla si:

a) informacion në lidhje me të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzimet dhe raportet e brendshme të korporatës;

d) të dhënat personale të personave fizikë.

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të zgjedhura në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohen gjatë Periudhës gjithëpërfshirëse me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) degët e KfW- së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose entitetet/subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh të zhvillimit gjerman, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe të anëtarëve të tyre, veçanërisht Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë ka kërkuar që KfW-ja të ndajë informacione të zgjedhura në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohet gjatë Periudhës gjithëpërfshirëse me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë seksione të lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Iniciativës për Transparencën e Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Gjermany Trade and Invest (GTAI), për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD, për qëllim të raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllim të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>).

8.4 KfW-ja më tej rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë për qëllime të publikimit) informacion mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi ato financohen gjatë Periudhës gjithëpërfshirëse ndaj palëve të treta, në mënyrë që të mbrojnë interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk janë transferuar, tejkalojnë interesat e KfW-së në të, cilat transferohen. Interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta nëse është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore ose për të pohuar ose mbrojtur pretendimet ose të drejta të tjera ligjore në gjykata ose procedura administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në Aneksin 1 a (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Marrësit). Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në Aneksin 1 b (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë të Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në këtë mënyrë. Çdo boshllëk që rezulton prej tyre duhet të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 As Marrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të caktojnë, transferojnë, ose pengojnë ndonjë kërkesë nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përmbushjes do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit të krijuara nga kjo Marrëveshje përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit përfundimtar.

9.6 Kjo Marrëveshje Financimi nuk do të hyjë në fuqi derisa Marrëveshja Qeveritare në të cilën është bazuar, të ketë hyrë në fuqi dhe KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Marrësit që procedurat e brendshme që duhet të përmbushen nga Marrësi janë përfunduar.

Hartuar në tri origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
në datën 5.3.2019

KfW
e përfaqësuar

Republika e Shqipërisë,

Emri:
Titulli:

Emri:
Titulli:

Operatori i Shpërndarjes së
Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE)

Emri:
Titulli:

Emri:
Titulli:

Shtojcat

- 1a - Angazhime të Pajtueshmërisë së Marrësit
- 1b - Angazhime të Pajtueshmërisë së Agjencisë të Zbatimit të Projektit

SHTOJCA 1A ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIMET

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi ose dëmi, ose kërcënimi për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi.

Praktikë e Fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave të hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e paefektshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, kërkimi ose nxitja drejtpërdrejt ose tërthorazi, e çdo pagese të paligjshme ose avantazhit të çdo natyre, nga ndonjë person, me qëllimin e ndikimit në veprimet e çdo personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Praktikë Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin, që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Praktikë Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provave materiale për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese ose të fshehte; ose ii) çdo veprim që synon të pengojë materialisht ushtrimin e qasjes së KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim ose kërcënim, ngacmim ose frikësim të çdo personi për të parandaluar zbulimin e njohurive të tij për çështje lidhur me hetimin ose ndjekjen e hetimit; hetimet zyrtare në pretendimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese ose praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pa inkorporuar.

Praktikë e Sanksionueshme: Çdo praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Penguese (siç janë përcaktuar këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; kanë një efekt material ligjor ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose zbatimin e tij.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ Sanksionues: cildo nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve, të lëshuara nga çdo Organ Sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Marrësi:

a) do vendosë menjëherë në dispozicion, me kërkesë të KfW- së, “njihni klientin tuaj” ose informacione të ngjashme në lidhje me Marrësin, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, menjëherë t’i paraqesë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e lidhura me Projektin e Marrësit dhe (nën)kontraktuesit e tij dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar çdo praktikë të sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Marrësin që është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do të informojë KfW-ne menjëherë dhe vetë, sapo të dijë ose dyshojë për çdo praktikë të sanksionueshme, aktin e pastrimit të parave dhe / ose financimin e terrorizmit që lidhet me Projektin;

d) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do t’i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet e tilla mbi Projektin dhe përparimin e tij të mëtjeshëm, siç mund të kërkojë KfW për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do i mundësojë KfW-në dhe agjentëve të saj që në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Projektit të Marrësit dhe kontraktuesit (nënkontraktues) të saj dhe palëve të tjera të lidhura me të, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me to për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket ligjit gjerman ose ligjit të vendit të Marrësit, ky i fundit përfaqëson që asnjë nga personat që kanë lidhje me Projektin në emër të Marrësit nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në asnjë praktikë të Sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Do të konsiderohet të përsëritet pas çdo tërheqjeje të kontributit financiar, duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi merr përsipër, sa më shpejt që Marrësi ose KfW-ja të njoftohen ose të dyshojnë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, të veprimet të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Marrësi do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW dhe do të ofrojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk do të hyjë në ndonjë transaksion ose nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Projektin që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

SHTOJCA 1B ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË AGJENCISË TË ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

1. PËRKUFIZIMET

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi ose dëmi, ose kërcënimi për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e Fshtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e projektuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar të veprimeve të një personi tjetër.

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, pranimi, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi i papërshtatshëm i

çdo natyre, nga ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e çdo personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar.

Kategoritë e caktuara të veprave penale: kategoritë e mëposhtme të veprave penale të përcaktuara nga rekomandimet e TFVF-së dhe shënimet interpretuese përkatëse: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe grumbullimi; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve; shfrytëzimin seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimin e paligjshëm të barnave narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimin e paligjshëm i armëve; trafikimin e paligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsion dhe ryshfet; mashtrim; falsifikim të monedhës; falsifikim dhe pirateri të produkteve; krim mjedisor; vrasje, lëndim i rëndë trupor; rrëmbim, mbajtje të paligjshme dhe marrje pengjesh; grabitje ose vjedhje; kontrabandë (duke përfshirë në lidhje me doganat dhe akcizat dhe taksat); krime tatimore (lidhur me taksat e drejtpërdrejta dhe taksat e tërthorta); zhvatje; falsifikim; pirateri; tregti të brendshme dhe manipulim të tregut

Rekomandimet e TFVF-së: rekomandime të tilla siç përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (TFVF). TFVF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktikë Mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose synon të mashtrojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Origjina e paligjshme: origjina e fondeve të fituara nëpërmjet

- a) çdo veprë penale të shënuar në Kategoritë e Caktuara të Veprave Penale;
- b) çdo praktikë korruptive;
- c) çdo praktikë mashtruese ose
- d) pastrim parash

Praktikë Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provës materiale për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese ose të fshehtë; ose ii) çdo veprim që synon të pengojë materialisht ushtrimin e qasjes së KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim ose kërcënim, ngacmim ose frikësim të çdo personi për të parandaluar zbulimin e njohurive të tij për çështje të lidhura me hetimin ose ndjekjen e hetimit; hetimet zyrtare në pretendimet për një praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese ose praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e painkorporuar.

Praktikë e Sanksionueshme: Çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Shkatërruese (siç janë përcaktuar këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; kanë një efekt material ligjor ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose zbatimin e tij.

Sanksionet: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ Sanksionues: cilido nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së gjithçka të rëndësishme në lidhje me “njihni klientin tuaj” ose informacione të ngjashme në lidhje me Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe çdo aksioner, filial dhe/ose çdo degë tjetër (nëse ka), siç KfW-ja mund të kërkojë;

b) do t'i paraqesë menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e lidhura me Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën) kontraktimin e

tij dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim;

c) do të informojë menjëherë dhe me pëlqimin e vet KfW-në, sapo të njihet ose dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, aktin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, ndonjë anëtar i organeve të tij drejtuese ose organeve të tjera qeverisëse ose ndonjë prej aksionerëve të saj;

d) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet e tilla mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe përparimin e tij të mëtejshëm, siç mund të kërkojë KfW-ja për qëllimet e kësaj shtojce;

e) do t'i mundësojë KfW-së dhe agentëve të saj që në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër të Shërbimit të Ekspertëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën) kontraktimin e tij dhe palëve të tjera të lidhura me të, dhe të vizitojnë Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet që lidhen me qëllimet e kësaj shtojce.

f) të informojë menjëherë dhe me pëlqimin e vet KfW-në, për çdo ngjarje që rezulton në çdo Agjenci të Zbatimit të Projektit, çdo anëtar i organeve të tij drejtuese apo organeve të tjera qeverisëse ose ndonjë prej aksionerëve të saj, që janë ose që bëhen shtetas të caktuar posaçërisht, persona të bllokuar ose subjekte të përfshira në ndonjë Listë Sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se të dhënat e mëposhtme janë të vërteta dhe të sakta:

a) në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër dhe për llogari të vet;

b) sipas njohurive të tij më të mira dhe vetëm në lidhje me aksionerët e njohur në Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me rregulloret e tregut të aksioneve, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk janë me Origjinë të Paligjshme;

c) asnjë nga Agjencitë Zbatuese të Projektit, filialet e saj ose ndonjë person tjetër që vepron në emër të tij ose në emër të tyre, nuk ka kryer ose nuk është i angazhuar në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk ka: i) hyrë në ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas të posaçëm të caktuar, persona të bllokuar ose subjekte të përfshirë në ndonjë Listë Sanksionesh; ose ii) nuk është përfshirë në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritshme në çdo hartim të Kontributit Financiar, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër

a) të jetë plotësisht në përputhje me standardet e financimit të pastrimit të parave dhe terrorizmit në përputhje me rekomandimet e TFVF-së dhe të zbatojë, ruajë dhe, nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet e saj të brendshme dhe udhëzimet (duke përfshirë pa kufizime në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit) çdo Praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të njoftohen ose dyshojnë se çdo Praktikë e Sanksionueshme, veprim i pastrimit të parave ose financim i terrorizmit, do të bashkëpunojnë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë i pajtueshmërisë. Në veçanti, Agjencia për Zbatimin e Projektit do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të japë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër:

a) të sigurojë që kapitali i saj dhe fondet e tjera që investon nuk do të jenë me Origjinë të Paligjshme;

b) të sigurojë që biznesi i saj nuk do të krijojë asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim të terrorizmit; dhe

c) të mos hyjë ose të mos vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të posaçëm të caktuar, persona të bllokuar ose subjekte që përfshihen në ndonjë listë të sanksioneve dhe të mos angazhohen në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte Shkelje të Sanksioneve.